

# Barometri i Reformave Evropiane



Shkurt 2025

**Titulli i publikimit:**

Barometri i Reformave Evropiane –  
shkurt 2025

**Publikuar nga:**

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)  
Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK)

**Dizajni grafik:**

2vo

Prishtinë, shkurt 2025

Ky raport është hartuar me mbështetjen e  
Ambasadës së Holandës në Kosovë. Përmbajtja  
e tij është përgjegjësia e vetme e Grupit për  
Studime Politike dhe Juridike dhe Institutit të  
Kosovës për Politikën Evropiane dhe në asnjë  
formë nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës  
së Holandës në Kosovë.



Group for Legal  
and Political  
Studies

epik.

**NL** Netherlands

# Barometri i Reformave Evropiane

## Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia	4
Përmbledhja ekzekutive	7
Rangimi Evropian	8
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	9
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	15
Ministria e Punëve të Brendshme	22
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	28
Ministria e Drejtësisë	32
Ministria e Ekonomisë	36
Zyra e Kryeministrit	41
Ministria e Shëndetësisë	45
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Infrastrukturës	48
Ministria për Komunitete dhe Kthim	53
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	56
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	61
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	64
Ministria e Zhvillimit Rajonal	67

# Hyrje

Në vitin 2023 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane (EPIK), me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, kanë bashkuar forcat për të dizajnuar një instrument të ri për vlerësimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të performancës së Qeverisë së Kosovës në zbatimin e reformave Evropiane. Në këtë sfond në janar të vitit 2024 ne publikuam Barometrin e parë të Reformave Evropiane.

Sot kemi kënaqësinë të prezantojmë Barometrin e dytë të Reformave Evropiane 2025. Barometri ka tre qëllime parësore: (1) të avancojë diskursin publik mbi zbatimin e reformave të BE-së duke i komunikuar ato në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për publikun e gjerë; (2) të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë duke ofruar vlerësim strikt, por të drejtë, të performancës së ministrive të linjës në zbatimin e reformave të BE-së; dhe (3) të mbështes ministritë në dizajnimin sa më efektiv të reformave evropiane duke ofruar analizë objektive dhe empirike mbi kornizën planifikuese të qeverisë në fushën e integrimit evropian.

Për të arritur këtë ne është dashur të hartonim një metodologji të veçantë që synon të ofrojë një vlerësim gjithëpërfshirës të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integrimit evropian duke marrë për bazë dokumentin kryesor planifikues të ekzekutivit në fushën e integrimit Evropian: Programin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Periudha e vlerësimit të këtij barometri është janar – dhjetor 2024.

Duam të falënderojmë të gjitha ministritë e linjës për bashkëpunimin gjatë përgatitjes së barometrit, si dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës, pa mbështetjen e së cilës nuk do të ishte i mundur realizimin e këtij projekti.

## Metodologjia

Barometri i Reformave Evropiane është zhvilluar mbi një metodologji unike e cila është dizajnuar për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës të cilësisë së kornizës planifikuese të Qeverisë në fushën e integrimit evropian.

Vlerësimi tradicional i performancës së qeverisë bazohet ekskluzivisht në një kriter vlerësues: shkalla e zbatueshmërisë së kornizës planifikuese. Sidoqoftë, ne kemi konsideruar se një vlerësim i tillë nuk do të ishte i mjaftueshëm dhe i drejtë; dhe si i tillë do të na ofronte një pikturë të pakompletuar të performancës së ministrive në procesin integruar. Rrjedhimisht metodologjia e barometrit bazohet në katër kritere të vlerësimit të cilat ofrojnë një vlerësim më holistik dhe më të drejtë:

1. Kriteri i parë i kompleksitetit bënë vlerësimin e vështirësisë së masave të Qeverisë. Pra, jo të gjitha masat e planifikuara nga ana e ministrive të linjës kanë peshën dhe vështirësinë e barabartë. Disa masa janë shumë më të vështira për tu zbatuar se disa të tjera.

Përgatitja e një strategjie dhe organizimi i një trajnimit nuk është e njëjta gjë. Rrjedhimisht, qëllimi i këtij kriteri është që të sigurojë se vlerësimi përfundimtar i performancës së ministrive në zbatimin e reformave evropiane merr parasysh kompleksitetin e masave për të cilat ministrat janë zotuar, duke shpërblyer kështu ato ministrat të cilat kanë bërë një planifikim më serioz dhe më të avancuar të reformave evropiane. Ky kriter bart 25% të pikëve totale të vlerësimit.

2. Kriteri i dytë bënë vlerësimin e saktësisë së kornizës planifikuese të Qeverisë në procesin integruar. Pra është e rëndësishme që masat të cilat qeveria ka paraparë në kuadër të kornizës së saj planifikuese të janë në harmoni me obligimet të cilat qeveria ka marrë në kuadër të procesit integruar. Thënë ndryshe qëllimi i këtij kriteri është që të sigurojë se Qeveria është duke bërë gjërat e duhura në procesin integruar, duke shpërblyer kështu ato ministrat të cilat kanë siguruar një përputhshmëri më të madhe në mes obligimeve në procesin integruar dhe kornizës planifikuese të ministrisë. Ky kriter bart 35% të pikëve totale të vlerësimit.
3. Kriteri i tretë është kriteri klasik i cili thjesht bënë vlerësimin e zbatueshmërisë së kornizës planifikuese nga ana e ministrive, duke shpërblyer kështu ministrat me shkallën më të lartë të zbatimit të masave në kuadër të procesit integruar. Ky kriter bart 30% të pikëve totale të vlerësimit.
4. Kriteri i katërt është vlerësimi i një faktori të jashtëm për performancën e çdo ministrie e ai është vlerësimi i Komisionit Evropian në kuadër të raportit të BE-së. Raporti i BE-së ofron një vlerësim të kuantifikueshëm të performancës vjetore të Kosovës në kuadër të kapitujve të ndryshëm të BE-së. Në masë të madhe këto kapituj përputhen me mandatet dhe fushë përgjegjësitë e ministrive të linjës. Rrjedhimisht qëllimi i këtij kriteri është që të shpërblejë me pikë shtesë ato ministrat të cilat Komisioni Evropian ka vlerësuar se kanë bërë progres vjetor më të madh se vitin paraprak. Ky kriter bart 10% të pikëve totale të vlerësimit.

Mbledhja totale e pikëve të fituara në kuadër të katër kriterëve ofron rezultatin përfundimtar të performancës së ministrisë në kuadër të zbatimit të reformave evropiane. Çdo ministri eventualisht fiton një numër të pikëve në shkallën nga 0 deri 100, sipas gradimit të më poshtëm:

- 0-25 pikë** performancë e dobët;
- 26-50 pikë** performancë e kufizuar;
- 51-75 pikë** performancë e mirë;
- 76-100 pikë** performancë shumë e mirë.

Duhet nënvizuar se unikaliteti i barometrit qëndron në faktin se është dashur të dizajnohet një metodologji e veçantë e cila me një anë do të jetë mjaft teknike për të analizuar kornizën komplekse dhe voluminoze të planifikimit të qeverisë në fushën e integritimit evropian, por në anën tjetër do të jetë mjaft e thjeshtë dhe e qartë për të kuptuar jo vetëm nga ana e ministrive të linjës, por edhe nga ana e publikut të gjerë. Kjo është edhe arsyeja përse produkti final i barometrit përbëhet nga tre nivele të informatave për tre audiencat e ndryshme.

Niveli i parë dhe më voluminozi është ai i vlerësimit teknik të ministrive ne formatin Excel. Ky nivel i barometrit është i menduar për diskutime teknike në nivel të ekspertëve. Ai po ashtu shërben si bazë e të dhënave teknike për ndërtimin e niveleve të tjera të barometrit.

Niveli i dytë i barometrit është ai në formatin Word i cili prezanton të dhënat teknike të Excelit në një format më të kuptueshëm dhe të lexueshëm për audiencën e cila nuk përcjell procesin integruar në baza ditore. Ky nivel i barometrit është i menduar për nivelin e vendimmarrëseve institucional, ambasadat e huaja, OJQ-të dhe mediat.

Niveli i tretë i barometrit është ai i platformës online i cili në mënyrë vizuale dhe interaktive prezanton gjeturat më të rëndësishme lidhur me performancën e ministrive në procesin integruar. Ky nivel i barometrit është i menduar për audiencën e gjerë me ç'rast çdo kush me një klikim mund të kuptojë përgjegjësitë dhe performancën e ministrive në kuadër të reformave evropiane.

Në fund është e dobishme të sqarojmë edhe çfarë barometri nuk është. Barometri nuk është vlerësues i punës së të gjitha institucioneve të Kosovës në fushën e integritetit Evropian. Rrjedhimisht institucione të rëndësishme sikur Kuvendi, prokuroria, gjyqësori dhe institucione të tjera të pavarura nuk janë pjesë e këtij vlerësimi. Arsyeja mbrapa këtij vendimi është teknike dhe financiare. Pra teknike pasi që duke pas parasysh që barometri është një instrument krejtësisht i ri kemi dashur të testojmë suksesin e tij brenda një grupi institucionesh të cilat kanë një koherencë dhe uniformitet funksionimi. Kjo do të na ofronte një mjedis të kontrollueshëm dhe të krahasueshëm të barometrit. Po ashtu, vendimi ynë është udhëhequr edhe nga fakti që ekzekutivi bart përgjegjësinë krahasimisht më të madhe brenda procesit integruar. Njëkohësisht, vendimi për të filluar barometrin vetëm me ekzekutivin ishte edhe i natyrës financiare pasi që zgjerimi në më shumë institucione do të ndikonte në vëllimin financiar të projektit i cili momentalisht kishte kufizime e veta objektive. Barometri po ashtu nuk është vlerësues i performancës së përgjithshme të ministrive. Nuk duhet konfuzuar vlerësimin dhe rangimin e ministrave brenda këtij barometri me performancën e përgjithshme të ministrave. Ministrat udhëheqin ministritë me fushë përgjegjësitë jashtëzakonisht të gjëra të cilat tejkalojnë obligimet e tyre në procesin integruar. Rrjedhimisht, është e domosdoshme të nënvizohet se rangimi i ministrave në kuadër të barometrit ka të bëjë ekskluzivisht me performancën e dikastereve që ata udhëheqin brenda fushës së integritetit evropian.

# Përmbajtja ekzekutive

Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga 15 ministri, plus Zyra e Kryeministrit. Dy nga këto ministri – Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – nuk janë pjesë e këtij barometrit pasi që ato nuk kanë pasur obligime në kuadër të agjendës evropiane gjatë vitit 2024. Kjo na lë me 14 ministri (përfshirë Zyrën e Kryeministrit) që u përzgjedhën për të qenë pjesë e barometrit.

Nga 14 ministri gjatë vitit 2024 një ministri tregoj performancë shumë të mirë në zbatimin e reformave të BE-së, pesë ministri treguan performancë të mirë, gjashtë ministri treguan performancë të kufizuar dhe dy ministri treguan performancë të ulët.

Ministria që tregoj performancë shumë të mirë është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 83 pikë.

Pesë ministri me performancë të mirë janë:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - 68 pikë;
2. Ministria e Punëve të Brendshme - 64 pikë;
3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - 61 pikë
4. Ministria e Drejtësisë - 57 pikë;
5. Ministria e Ekonomisë: - 54.5 pikë;

Gjashtë ministri me performancë të kufizuar janë:

1. Zyra e Kryeministrit – 48 pikë;
2. Ministria e Shëndetësisë – 48 pikë;
3. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – 44 pikë;
4. Ministria për Komunitete dhe Kthim – 42 pikë;
5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – 34 pikë;
6. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – 30 pikë.


Dy ministri me performancë të ulët janë:

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – 25 pikë;
2. Ministria e Zhvillimit Rajonal – 0 pikë.

Në fund kjo ka rezultuar me vlerësimin përfundimtar të gjithë Qeverisë me 47 pikë totale, duke e vlerësuar kështu me performancë të kufizuar në ndërmarrjen e reformave evropiane gjatë vitit 2024.

# Rangimi Evropian

Infografika e rangimit të ministrave sipas performancës



# Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)



83/100 pikë

Gjatë vitit 2024 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka treguar performancë shumë të mirë në përmbushjen e reformave evropiane. Në total ajo ka fituar 83 pikë. Në kornizën e planifikimit të qeverisë në fushën e integritimit evropian, MFPT karakterizohet nga një planifikim masash mjaft kompleks. Gjithashtu, MFPT ka siguruar një zbatim të konsoliduar të masave të planifikuara për vitin 2024. Megjithatë, nga ana tjetër, kuadri i planifikimit të politikave MFPT karakterizohet me mospërputhje ndërmjet kornizës së planifikimit të politikave dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE. Sidoqoftë, përpjekjet e saja gjatë vitit 2024 u vlerësuan pozitivisht nga ana e Komisionit Evropian në veçanti në kuadër të kapitullit 19: politikat sociale dhe punësimi, si dhe kapitullit 29: bashkimi doganor.

## Vlerësimi i kriterit 1:

### Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit të parë, përkatësisht kompleksitetit të masave, korniza planifikuese e MFPT-së karakterizohet me një planifikim mjaft kompleks të masave. Shtatëdhjetë e një përqind (71%) e masave të MFPT-së kanë një natyrë të kompleksitetit të lartë. Shumica e masave të MFPT-së janë specifike, të matshme dhe shumë prej tyre konsiderohen reforma thelbësore në fushat që mbulon kjo ministri. Masat e MFPT-së janë gjithashtu pjesë e reformave kyçe të parashikuara me MSA. Në shumë raste ato kërkojnë transpozim të legjislacionit të BE-së dhe koordinim ndërsektorial.

## Vlerësimi i kriterit 2:

### Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi ndërmjet kornizës planifikuese të qeverisë me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, MFPT karakterizohet me një shkallë të lartë të harmonizimit. Tetëdhjetë e shtatë përqind (87%) e detyrimeve që rrjedhin nga agjenda evropiane janë adresuar në kuadër të kornizës planifikuese të MFPT-së. Në ciklet e ardhshme të planifikimit, MFPT duhet të angazhohet drejt miratimit të ligji të ri për MFP bazuar në praktikën e mira të BE dhe harmonizimit të këtij ligji me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Po ashtu, Kosova duhet të krijojë një shërbim koordinues kundër mashtrimit (AFCOS) dhe të përgatis strategjinë kombëtare për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

## Vlerësimi i kriterit 3:

### Zbatimi i masave të planifikuara

Përsa i përket kriterit të tretë, përkatësisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, MFPT karakterizohet me një shkallë e konsoliduar zbatimi. Më shumë se gjysma e masave të planifikuara, më saktë 65% janë zbatuar. Në të ardhmen, ndër tjera, MFPT duhet të angazhohet për të miratuar Projektligjin për Prokurimin Publik, Projektligjin për Ndhimën Shtetërore, Projektligjin për Partneritetet Publiko-Private dhe Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

## Vlerësimi i kriterit 4:

### Vlerësimi i Komisionit Evropian

Në kuadër të mandatit të MFPT-së bienn katër kapituj të BE-së: kapitulli 16: tatimet, kapitulli 17: politika ekonomike dhe monetare, kapitulli 19: politika sociale dhe punësimi dhe kapitulli 29: bashkimi doganor. Në kuadër të vitit 2024, sipas vlerësimit të KE-së, MFPT ka treguar performancë më të mirë se vitin e kaluar në dy kapituj – kapitullin 19 dhe 29. Për këtë arsye MFPT ka marrë vlerësim pozitiv prej dhjetë pikësh në kuadër të këtij kriteri.

### Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdesshme financiarisht. Në raste të tjera, ato nuk janë të tilla. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioritet i MSA-së	Masa për afron Acquis	Ndjeshmëria politike	Totali
UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë), i miratuar	K3 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	0	0	6
UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore), i miratuar	K3 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	0	0	6
Projektligji për prokurimin publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (plotësim-ndryshim), i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	1	0	5
Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	1	0	5
Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	1	1	1	1	0	6
Projektligji për bankat, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Një dokument lidhur me rreziqet fiskale, i hartuar	K2 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Raportimi i rregullt gjashtëmuor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K3 2024	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Raportimi i rregullt vjetor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K2 2024	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Numri i aktiviteteve në kuadër të projekteve për përmirësimin e përbushjes tatimore, i rritur	K4 2024	PKIE	1	0	0	1	1	0	1	0	0	4
Numri i aktiviteteve (inspektimeve, ndalo&kërko dhe patrullë) kundër kontrabandës bazuar në analizën e rrezikut i rritur në krahasim me periudhën paraprake, i rritur	K4 2024	PKIE	1	0	0	1	1	0	1	0	0	4
Numri i marrëveshjeve bilaterale me vendet e rajonit dhe BE, të iniciuara	K4 2024	PKIE	1	0	0	1	1	1	1	0	0	5

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së	Masa për afron Acquis	Ndëshmëria politike	Totali
Vlerësimi kombëtar i rrezikut, i iniciuar	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Tipologjitë e pastrimit të parave për PEP, të hartuara dhe publikuara	K2 2024	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Metodologjia për inspektimin e auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore të auditimit, e hartuar	K3 2024	PKIE	1	1	0	0	1	0	1	0	0	4
Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të Komitetit Ndërkombëtar të Interpretimeve për Raportim Financiar (KNIRP), si dhe interpretimet e lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK)	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe udhëzimet përkatëse të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS), të zbatuara	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Katër (4) trajnime për dhënësit e ndihmës për njoftimin dhe raportimin e ndihmës shtetërore dhe për rregullat de minimis, lidhur me raportimin dhe kalkulimin e ndihmës, të mbajtura	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore, në krahasim me vitin paraprak	K4 2024	PKIE	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Dy analiza të kryera për bashkëpunimin, koordinimin dhe komunikim ndërinstitucional lidhur me përgjegjësitë për parandalimin dhe uljen e punës së padeklaruar	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Kriteret e vlerësimit të rrezikut, të përcaktuara	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	0	0	4
Plani për Zbatimin e Skemës së Garantuar për të Rinj, i pilotuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Numri inspektorëve të punës, i rritur për 40 inspektorë	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Numri i inspektimeve nga Inspektorati i Punës, i rritur	K4 2024	PKIE	1	0	0	1	0	0	1	0	0	3
Skema a Asistencës Sociale i Zbatuar sipas Ligjit të ri të Skemës së Ndhmës Sociale, e pilotuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Plani Strategjik i Doganës së Kosovës 2024-2027, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Zyrtarët e rinj, të rekrutuar	K3 2024	PKIE	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
Zhvendosja në pronë publike dhe funksionalizimi i plotë për së paku 2 terminale doganore	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	1	1	1	0	0	5
UA për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik (SSP), i zbatuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Përqindja												71%
<b>Rezultati i përgjithshëm</b>												<b>8</b>

## Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministritë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministritë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Miratimi i Ligjit të Ri për Prokurim.	Projektligji për prokurimin publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	1
Eshte theksuar nevoja për të vazhduar përafrimin me acquis për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, për të miratuar legjislacionin zbatues	"Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar"	1
Të rishikohet baza ligjore dhe roli i Komiteteve të Auditimit;	"Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (plotësim-ndryshim), i miratuar  UA për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik (SSP), i zbatuar"	1
Përafrimi i mëtejshëm me acquis për raportimet e kompanive dhe forcimin e strukturave të mbikëqyrjes së auditimit institucional dhe pavarësinë profesionale dhe objektivitetin e auditorëve dhe firmave të auditimit, duke përfshirë financimin e nevojshëm dhe të qëndrueshëm;	Metodologjia për inspektimin e auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore të auditimit, e hartuar	1
Duhet të rritet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për Ndihmë shtetërore, sidomos duke pasur parasysh që Ligji për Ndihmë Shtetërore, rregulloret për ndihmën horizontale, duke përfshirë përjashtimin në bllok dhe ndihmën rajonale janë draftuar por nuk janë miratuar;	"Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar"	1
Miratimi i Kodit Doganor të Kosovës dhe Kodit të Akcizave të ndryshuara është i rëndësishëm për përafrimin e mëtejshëm me legjislacionin dhe praktikën e BE-së.	Kodi Doganor i Kosovës dhe Kodi i Akcizës është miratuar, dhe publikuar ne Gazetën zyrtare më 10.05.2024	1
Miratimi i Ligjit për Koncesionet	"I adresuar përmes Masës Legjislative: 3.5.2. Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar"	1
Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me acquis për shërbimet e pagesave, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe me kuadrin e Bazelit, duke përfshirë përgatitjen e një udhërrëfyese për t'u përafruar me Solvency II.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në fushën e shërbimeve të pagesave, obligimi është adresuar në afat të mesëm (2025 e tutje). Realisht projekt ligji për Shërbimet e pagesave është hartuar, konsultuar dhe aprovuar në Qeveri në 2024.</li> <li>Në fushën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është i adresuar përmes Masave Legjislative: <ul style="list-style-type: none"> <li>3.4.1. UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë), i miratuar.</li> <li>3.4.2. UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore), i miratuar.</li> </ul> </li> <li>Në kuadrin e Bazelit, duke përfshirë përgatitjen e një udhërrëfyese për t'u përafruar me Solvency II, është i adresuar përmes: 3.9.10. Neni 50 Zbatimi i mëtejshëm i udhërrëfyesisit për transpozimin e ardhshëm të regjimit Solvency 2.</li> </ul>	1

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Kosova gjithashtu ka nevojë për përpjekje të shtuara për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar dhe për të zbatuar masat e Solvency I.	Siç u tha më lartë, pas Solvency I kanë filluar edhe përgatitjet për zbatimin e Solvency II.	1
Te sigurohet përputhja me tavanin ligjor për pensionet e veteranëve të luftës dhe me rregullën e faturës së pagave, dhe të ndërmarrë një rishikim të shpenzimeve tatimore, duke përcaktuar sasinë e të ardhurave të harruara nga të gjitha përjashtimet, normat preferenciale dhe regjimet e veçanta;	Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti është publikuar ne gazetën zyrtare më 16.08.2023, prandaj nuk është pjesë e PKIE 2024-2028.	1
Të implementohet në mënyrë eficiente strategjia e re për MFP 2022-2026 dhe veprimet e saj relevante për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe auditimin e jashtëm	"Implementimi i adresuar përmes: 2.1.2. Raportimi i rregullt gjashtëmujor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024, dhe 2.1.3. Raportimi i rregullt vjetor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024"	1
Kosova gjithashtu nuk ka krijuar ende një shërbim koordinues kundër mashtrimit (AFCOS) dhe nuk është zhvilluar ende një strategji kombëtare kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.		0
Të zhvillohet dhe miratohet ligji i ri për MFP bazuar në praktikën e mira të BE dhe të harmonizohet ky ligj me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;		0
Përqindja		87%
Rezultati i përgjithshëm		9

### Kriteri 3: Shkalla e zbatimit

Qëllimi i këtij vlerësimi është të matë zbatimin e masave të planifikuara në Programin Kombëtar për Integrim Evropian.

Masa	Afati	Referenca	Zbatimi
UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë), i miratuar	K3 2024	PKIE	0
UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore), i miratuar	K3 2024	PKIE	0
Projektligji për prokurimin publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	0
Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	0
Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (plotësim-ndryshim), i miratuar	K4 2024	PKIE	1
Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	0
Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar	K4 2024	PKIE	1
Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar	K4 2024	PKIE	0
Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar	K4 2024	PKIE	0
Projektligji për bankat, i miratuar	K4 2024	PKIE	1
Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës (plotësim-ndryshim), i miratuar	K2 2024	PKIE	0
Një dokument lidhur me rreziqet fiskale, i hartuar	K2 2024	PKIE	1
Raportimi i rregullt gjashtëmujor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K3 2024	PKIE	1
Raportimi i rregullt vjetor mbi zbatimin e Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K2 2024	PKIE	1
Numri i aktiviteteve në kuadër të projekteve për përmirësimin e përmbushjes tatimore, i rritur	K4 2024	PKIE	1

Numri i aktiviteteve (inspektimeve, ndalo&kërko dhe patrullë) kundër kontrabandës bazuar në analizën e rrezikut i rritur në krahasim me periudhën paraprake, i rritur	K4 2024	PKIE	1
Numri i marrëveshjeve bilaterale me vendet e rajonit dhe BE, të iniciuara	K4 2024	PKIE	1
Vlerësimi kombëtar i rrezikut, i iniciuar	K4 2024	PKIE	1
Tipologjitë e pastrimit të parave për PEP, të hartuara dhe publikuara	K2 2024	PKIE	1
Metodologjia për inspektimin e auditorëve ligjorë dhe firmave ligjore të auditimit, e hartuar	K3 2024	PKIE	0
Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të Komitetit Ndërkombëtar të Interpretimeve për Raportim Financiar (KNIRP), si dhe interpretimet e lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK)	K4 2024	PKIE	0
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe udhëzimet përkatëse të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS), të zbatuara	K4 2024	PKIE	0
Katër (4) trajnime për dhënësit e ndihmës për njoftimin dhe raportimin e ndihmës shtetërore dhe për rregullat de minimis, lidhur me raportimin dhe kalkulimin e ndihmës, të mbajtura	K4 2024	PKIE	1
Ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore, në krahasim me vitin paraprak	K4 2024	PKIE	1
Dy analiza të kryera për bashkëpunimin, koordinimin dhe komunikim ndër-institucional lidhur me përgjegjësitë për parandalimin dhe uljen e punës së padeklaruar	K4 2024	PKIE	1
Kriteret e vlerësimit të rrezikut, të përcaktuara	K4 2024	PKIE	1
Plani për Zbatimin e Skemës së Garantuar për të Rinj, i pilotuar	K4 2024	PKIE	1
Numri inspektorëve të punës, i rritur për 40 inspektorë	K4 2024	PKIE	0
Numri i inspektimeve nga Inspektorati i Punës, i rritur	K4 2024	PKIE	1
Skema a Asistencës Sociale i Zbatuar sipas Ligjit të ri të Skemës së Ndhmës Sociale, e pilotuar	K4 2024	PKIE	1
Plani Strategjik i Doganës së Kosovës 2024-2027, i miratuar	K1 2024	PKIE	1
Zyrtarët e rinj, të rekrutuar	K3 2024	PKIE	1
Zhvendosja në pronë publike dhe funksionalizimi i plotë për së paku 2 terminale doganore	K4 2024	PKIE	1
UA për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik (SSP), i zbatuar	K4 2024	PKIE	1
Përqindja			<b>65%</b>
Rezultati i përgjithshëm			<b>7</b>

#### Kriteri 4: Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Çdo vit Komisioni Evropian publikon raportin vjetor të vendit për Kosovën. Në raport, KE përdor metodologji të matshme që lejon matjen e progresit vjetor të vendit në miratimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE sipas përshkrimit të mëposhtëm: (0) kthim prapa; (1) nuk ka përparim; (2) progres i kufizuar; (3) disa përparime; (4) progres i mirë; (5) progres shumë i mirë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të merr parasysh progresin që ka bërë çdo ministri e linjës gjatë periudhës së vlerësimit.

#### Kapitulli i raportit të vendit i BE-së

#### Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Kapitulli 16: Tatimet	0
Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare	0
Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi	10
Kapitulli 29: Bashkimi Doganor	10
Rezultati	<b>10</b>

# Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)



68/100 pikë

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) bën pjesë në grupin e ministrive me performancë të mirë. Është vlerësuar me 68 pikë nga gjithsej 100 pikë. Shumica e masave të planifikuara në vitin 2024 ishin të një kompleksiteti të lartë. Megjithatë, ekziston një përafrim i kufizuar ndërmjet kornizës së planifikimit të ministrisë dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE. Për më tepër, ministria arriti vetëm një progres të kufizuar sa i përket zbatimit të masave të planifikuara në vitin 2024. Sidoqoftë, përpjekjet e saja gjatë vitit 2024 u vlerësuan pozitivisht nga ana e Komisionit Evropian në veçanti në kapitullin 14: politikat e transportit.

## Vlerësimi i kriterit 1:

### Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit të parë, përkatësisht kompleksitetit të masave, korniza planifikuese e MMPHI-së karakterizohet me një planifikim mjaft kompleks të masave. Nëntëdhjetë e dy përqind (92%) e masave të ministrisë janë vlerësuar si masa komplekse. Shumica e masave të planifikuara nga MMPHI konsiderohen specifike dhe të matshme. Këto masa përfaqësojnë gjithashtu reformat kryesore të parashikuara nga MSA. Një sërë masash transpozojnë legjislacionin e BE-së dhe shumica kanë kërkesa të larta buxhetore dhe kërkojnë koordinim ndër-institucional.

## Vlerësimi i kriterit 2:

### Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi ndërmjet kornizës planifikuese të qeverisë me obligimet në kuadër të agjendës evropiane,

MMPHI karakterizohet me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të planifikimit. Katërdhjetë e katër përqind (44%) e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit në BE janë adresuar në kuadër të kornizës planifikuese të MMPHI-së. Megjithatë, pavarësisht shkallës së kufizuar të harmonizimit të planifikimit, duhet theksuar se MMPHI ka bërë përpjekje serioze për të adresuar gjetjet që dalin nga konkluzionet e Nënkomisionit për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rural.

Në ciklet e ardhshme të planifikimit MMPHI duhet të adresojë në veçanti kërkesat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, sidomos sa i takon përdorimit të karburanteve alternative, zbatimit të Planit të Veprimit Rajonal për Sigurinë Rrugore, zhvillimin e një Strategjie për Sigurinë në Rrugë. Për më tepër, sa i takon mjedisit, duhet adresuar edhe kërkesat rreth përfshirjes në kuadër ligjor të parimit ndotësi paguan, duhet harmonizuar kornizën ligjore dhe strategjike vendore me Agjendën e Gjelbër të BP-së, sigurimin e masave efektive për mbrojtjen e specieve të rrezikuara, zbatimin e plotë të kornizës strategjike të ndryshimeve klimatike, si dhe zhvillimin e një strategjie afat-gjatë të dekarbonizimit.

## Vlerësimi i kriterit 3:

### Zbatimi i masave të planifikuara

Përsa i përket kriterit të tretë, përkatësisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, MMPHI karakterizohet me një shkallë të kufizuar të zbatimit. Katërdhjetë e tetë përqind (48%) të masave të planifikuara janë zbatuar. Në të ardhmen, ndër tjera, MMPHI duhet të angazhohet për të miratuar projektligjin për patentë shofer, projektligjin për hekurudha, projektligjin për transportin rrugor, projektligjin për transportin e mallrave të rrezikshme, projektligjin për siguri hekurudhore, dhe projektligjin për mbrojtjen e mjedisit.

## Vlerësimi i kriterit 4:

### Vlerësimi i Komisionit Evropian

Në kuadër të mandatit të MMPHI-së bien dy kapituj të BE-së: kapitulli 14: politikat e transportit dhe kapitulli 27: mjedisi dhe ndryshimet klimatike. Në kuadër të vitit 2024, sipas vlerësimit të KE-së, MMPHI ka treguar performancë më të mirë se vitin e kaluar në kapitullin 14: politikat e transportit dhe rrjedhimisht ka marr vlerësim pozitiv prej dhjetë pikësh në kuadër të këtij kriteri.

### Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdesshme financiarisht. Në rast e të tjera, ato nuk janë të tilla. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së	Masa për afron Acquis	Ndleshmëria politike	Totali
UA për përcaktimin e rregullave për lëvizjen e lirë në treg të detergjenteve dhe substancave tension-aktive (surfaktantive), i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	0	1	1	1	0	6
Projektligji për automjete, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për patentë shofer, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për hekurudha, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për transportin rrugor, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për transportin e mallrave të rrezikshme, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për siguri hekurudhore, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për menaxhimin e resurseve ujore, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për mbrojtjen e natyrës, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Plotësim-ndryshimi i UA për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë, i miratuar	K3 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Plani i veprimit i strategjisë së ITS, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Sistemi për kontrollin e emetimit të gazrave të liruara nga automjetet, i funksionalizuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2025-2034 dhe plani i veprimit, e miratuar	K3 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Strategjia afatgjate e dekarbonizimit, e miratuar	K3 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe plani i veprimit 2024-2026, e miratuar	K2 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Plani për menaxhimin e pellgut të lumit Drini i Bardhë, i miratuar	K1 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Koncept dokumenti për fushën e mbeturinave, i miratuar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Katër (4) zyrtarë të trajnuar	K3 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrezikshmërisë së përmbytjeve, të finalizuara	K3 2024	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7

Njëmbëdhjetë (11) km shtigje të ecjes, të shenjëzuara	K4 2024	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Aplikacioni për raportim online për regjistrin e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, i zhvilluar	K4 2024	PKIE	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Raporti për inventarin e gazrave serrë, i përgatitur dhe i raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës	K3 2024	PKIE	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Inventari për emisionet në ajër për regjionin e Prishtinës, i përgatitur sipas viteve përkatëse	K4 2024	PKIE	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Përqindja	92%											
Rezultati i përgjithshëm	<b>10</b>											

## Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministrinë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministrinë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma (TM3/2023)	Ligji i miratuar	1
Miratimi i Ligjit për Ndryshime Klimatike (Q3/2023)	Ligji i miratuar	1
Filloni të hartoni një strategji afatgjatë të dekarbonizimit (TM2/2023)	Strategjia afatgjate e dekarbonizimit, e miratuar	1
Përgatitni një inventar të emetimeve të gazeve serë që mbulojnë deri në vitin 2021 (TM2/2023)	Raporti për inventarin e gazrave serrë, i përgatitur dhe i raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës	1
Miratimi i Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2022-2030 është ende i vonuar.	Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2025-2034 dhe plani i veprimit, e miratuar	1
Kosova duhet të harmonizojë mbrojtjen e saj mjedisore me Direktivën e përgjegjësisë mjedisore.	"Projektligji për mbrojtjen e natyrës, i miratuar Projektligji për mbrojtjen e mjedisit, i miratuar"	1
Kapacitetet inspektuese dhe zbatimi duhet të përmirësohen.	Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	1
Duhet të miratohen planet e cilësisë së ajrit për zonat ku nivelet e ndotësve tejkalojnë vlerat kufi.	Plani i cilesise se ajrit Prishtine, i miratuar	1
Kosova duhet të rrisë kapacitetet dhe të vendosë objektiva realiste të riciklimit për të zbatuar menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonominë qarkore.	"Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar Koncept dokumenti për fushen e mbeturinave, i miratuar"	1
Plani kombëtar i energjisë dhe klimës, duhet të miratohet në fund të qershorit 2024 (Shih Kapitullin 15 – Energjia).	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë i Republikës së Kosovës 2024-2030, i miratuar	1
Qeveria duhet të fillojë hartimin e një Strategjie të Dekarbonizimit, duke përfshirë veprimet në lidhje me energjinë, bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.	Strategjia afatgjate e dekarbonizimit, e miratuar	1

Kapacitetet administrative dhe inspektuese në sektor duhet të forcohen dhe duhet të zbatohen reformat strukturore sa i perket ndryshimeve klimatike .	Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	1
Rritja e ndërgjegjësimit sa i perket ndryshimeve klimatike duhet të rritet.	Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	1
Zbatimi i acquis sipas planit të veprimit rrugor të Komunitetit të Transportit (TM2/2023)	"1.Strategjia e Transportit Multimodal 2023-20230, e miratuar; 2.Plani i Veprimit i Strategjisë së Sistemit Inteligent të Transportit (SIT),i miratuar nga Qeveria 3.Projektligji për rrugët, i miratuar"	1
Përafrimi i Ligjit për Sigurinë dhe Ndërveprueshmërinë me Direktivat (BE) 2016/797 dhe (BE) 2016/798 (TM1/2024).	Projektligji per sigurinë hekurudhore i miratuar	1
Plotësoni transpozimin e artikujve të mbetur sipas fazës 1 të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). (2024).	Projektligji per aviacionin civil, i miratuar	1
Fillimi i përgatitjes së programeve të parandalimit të mbetjeve (TM3/2023).	Strategjia për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe plani i veprimit 2024-2026, e miratuar	1
Miratimi i Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Natyrës (T3/2023)	Koncept Dokumenti për Mbrojtjen e Natyrës, i miratuar	1
Hartimi i planit të veprimit për Biodiversitetin në përputhje me Strategjinë e Mjedisit (TM1/2024).	Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2025-2034 dhe plani i veprimit, e miratuar	1
Finalizimi dhe miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (TM4/2024).	Projektligji për Mbrojtjen e Natyres, i miratuar	0
Miratimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri", (TM4/2024) dhe miratimi i Planit Hapësinor "Bjeshkët e Nemuna" (TM3/2023)	Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri", i miratuar, ne proces te hartimit afati i planifikimit K1 2025 Plani Hapësinor iParkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". është miratur në Kuvendin e Republikës së Kosovës me daten 07.06.2023.	1
Lëshimi i lejeve të integruara për reduktimin e emetimeve të dëmshme industriale, veçanërisht për kompanitë shtetërore	LIGJI NR. 08/L-145 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES, i miratuar. MMPHI ne baze te Ligjit per IPPC leshon lejet e integruara per kompanite publike dhe private . Brenda vitit leshohen 4 deri ne 5 leje te integruara varesisht prej kerkesave.	1
Zbatimi i strategjisë së ndryshimeve klimatike dhe planit të veprimit për ndryshimet klimatike.	"1. Ka përfunduar Vlerësimi Preliminar i Rrezikut nga Përmbytjet për Pellgjet Lumore Drini i Bardhë, Lepenc dhe Sitnicë ne kuader te WBIF-it. 2. Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrezikshmërisë se përmbytjeve, të finalizuara 3. Kemi aplikuar për Planin e Menaxhimit të Vërshimeve dhe Thatësirave në kuader të runderit 30 te WBIF ne Qershor 2024"	1
Zbatimi i strategjisë së ndryshimeve klimatike 2019-2028 dhe planit të veprimit për 2021-2023 është shumë i kufizuar.	"1. Ka përfunduar Vlerësimi Preliminar i Rrezikut nga Përmbytjet për Pellgjet Lumore Drini i Bardhë, Lepenc dhe Sitnicë ne kuader te WBIF-it. 2. Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrezikshmërisë se përmbytjeve, të finalizuara 3. Kemi aplikuar për Planin e Menaxhimit të Vërshimeve dhe Thatësirave në kuader të runderit 30 te WBIF ne Qershor 2024"	1
